VENDIM
Nr. 118, datë 17.7.2020

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "GSA" SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR (SHITJE ME SHUMICË)

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 4, pika 50; 22, pika 2, germa "ç" dhe nenit 83, të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar; si dhe neneve 4, pika 1, germa "ç"; 5; 6; 8; 9 pika 1, germat: "a", "b", "c", "d", "e"; pika 2, germa "e" dhe nenin 12, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror", Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.7.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 83/2 prot., datë 2.7.2020 përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi licencimin e shoqërisë "GSA" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë),

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 5, datë 10.1.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë "GSA" sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror.
- Me shkresën nr. 41 prot., datë 14.1.2020, ERE ka përcjellë pranë shoqërisë njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës dhe kërkesën për plotësim të dokumentacionit
- Me *e-mailin* e datës 3.4.2020, për shkak të kufizimeve dhe situatës së krijuar nga COVID-19, shoqëria ka paraqitur kërkesë për shtyrje të afatit të plotësimit të dokumentacionit deri në normalizimin e gjendjes.
- Lidhur me këtë kërkesë të shoqërisë, Bordi i ERE-s është shprehur me vendimin nr. 70, datë 22.4.2020, duke zgjatur me 90 (nëntëdhjetë) ditë kalendarike afatin e vendimmarrjes finale për licencimin e shoqërisë "GSA" sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror, për një afat 10-vjeçar, deri më 12.7.2020.
- Shoqëria është njoftuar për këtë vendim nga ERE, me shkresën nr. 651 prot., datë 22.4.2020.
- Shoqëria "GSA" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 41/2 prot., datë 19.6.2020, ka përcjellë në ERE dokumentacionin e munguar të aplikimit.
- Shoqëria "GSA" sh.p.k. ka kryer pagesën e aplikimit sipas kërkesave të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017.
- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria "GSA" sh.p.k., në bazë të nenit 9, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017, rezulton i plotësuar, si më poshtë vijon:
- Neni 9, pika 1, germat "a", "b", "c", "d", "e". Plotësuar.
- Neni 9, pika 2, "i", "ii", "iii':

i. Sasinë mesatare të gazit natyror të shprehur në Milion Nm3, e parashikuar për t'u livruar gjatë një viti. Plotësuar.

ii. Garancinë që cilësia e gazit përmbush kriteret minimale të operatorit të sistemit. Plotësuar pjesërisht. Shoqëria "GSA" sh.p.k. ka përcjellë në ERE një deklaratë në të cilën shprehet se planifikon të operojë në fushën e tregtimit të gazit natyror duke përdorur rrjetin e transmetimit TAP Ag dhe rrjedhimisht do të tregtojë gaz natyror me standardet e cilësisë që TAP Ag mundëson, si dhe në përmbushje të të gjitha kritereve të cilësisë që përcaktohen në rregulloret e aplikueshme në

Shqipëri. Shoqëria deklaron se për shkak se ndodhet në hapat e para të licencimit, nuk disponon ende një marrëveshje me TAP Ag, por sapo të nënshkruhet një e tillë do ta paraqesë në ERE.

iii. Kapitalin financiar të nevojshëm për kryerjen e aktivitetit që kërkohet prej licencës dhe në veçanti për të mbuluar ekspozimin financiar të shkaktuar prej balancimit të gazit. Plotësuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "GSA" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë), për një afat 10-vjeçar.

2. Shoqëria "GSA" sh.p.k. të depozitojë në ERE garancinë e cilësisë së gazit para fillimit të ushtrimit të aktivitetit.

3. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti